

Shpallet konkurs për Imam në Xhaminë e Shqiptarëve në Melbourne, Australi

Shoqata Islame Shqiptare-Australiane (AAIS), përgjegjëse për xhaminë më të vjetër në Melbourne dhe vatër besimi për rreth 1,000 familje anëtare, shpall konkurs për pozitën e **Imamit**. Kërkojmë një kandidat të përkushtuar dhe vizionar për të udhëhequr komunitetin tonë në zhvillimin e tij shpirtëror dhe socialo-fetar

Detyrat dhe përgjegjësitë

- **Udhëheqja e adhurimeve:** Udhëheqja e namazeve ditore me xhemat, falja e Taravive, mbajtja e hutbeve të xhumasë në gjuhën shqipe dhe angleze, falja e namazeve të Bajramit dhe e netëve të mëdha.
- **Kujdesi shpirtëror:** Ofrimi i këshillimit teologjik për çështje personale dhe familjare, mbështjeja emocionale dhe udhëheqja me përkushtim e ritve të jetës fetare si (nikah, xhenaze, emërtimi i fëmijës), me dinjitet dhe profesionalizëm
- **Edukimi dhe arsimimi:** Organizimi i ligjëratave për të rinj dhe të rritur, si dhe përgatitja e materialeve edukative për faqen e internetit, buletin dhe rrjetet sociale.
- **Angazhimi social dhe integruet:** Përfaqësimi i AAIS në aktivitete ndërfetare dhe shoqërore, duke promovuar vlerat islame të mëshirës dhe drejtësisë.

Kualifikimet Profesionale:

- **Arsimimi:** Diplomë Bachelor në Studime Islame ose Ixhaze të akredituar (ose trajnim ekuivalent tradicional).
- **Njohuritë Kur'anore:** Lexim të bukur të Kur'anit, me memorizim dhe njohuri të thella në rregullat e Texhvidit.
- **Gjuhët:** Njohje e rrjedhshme e gjuhës shqipe dhe angleze.
- **Angazhimi Social:** Aftësi e dëshmuar për të afruar dhe angazhuar të rinjtë, mbështetje për vullnetarët dhe gatishmëri për bashkëpunim me komunitetin e gjerë.
- **Vetëdija Kulturore:** Vetëdije e lartë kulturore dhe fetare, me aftësi për t'i shërbyer një komuniteti të larmishëm.

- **Bashkëpunimi:** Frymë pozitive dhe gatishmëri e plotë për bashkëpunim me Këshillin Drejtues.
- **Teologjia:** Njohuri të thella mbi traditën e medhhebit Hanefi dhe aftësi për të promovuar balancën dhe unitetin në komunitet

Pse AAIS?

- **Traditë dhe vizion:** Trashëgimi 60-vjeçare me një bord drejtues që shikon përpara dhe është pro zhvillimit dhe integritetit
- **Komunitet aktiv:** Angazhim i lartë, me programe të rregullta dhe lidhje të qëndrueshme me komunitetin

Si të aplikoni

Ju lutemi dërgoni:

- CV
- Letër motivimi
- Linke ose incizime të dy hutbeve apo ligjëratave të fundit
- Mostër audio të leximit të Kur'anit

Të dërgohen në: admin@aais.org.au

Subjekti: ***Aplikim për Imam – [Emri Juaj]***
(Aplikimet pranohen vetëm përmes **emailit**)

Afati i fundit: E diel, **18 maj 2026**

Aplikimet e hershme inkurajohen; intervistat zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme.

Për informata shtesë kontaktoni:

Vëlla Abdur-Rahmaan Balla (WhatsApp): +61 400 331 697

(Vetëm për pyetje – aplikimet nuk pranohen përmes WhatsApp-it)

Përshkrimi i pozitës së imanit

Imami i Xhamisë Shqiptare do të punojë ngushtë me Këshillin Drejtues të AAIS, anëtarët, familjet dhe komunitetin më të gjerë. Ky rol kërkon qasje proaktive në përmbushjen e nevojave fetare, arsimore dhe shoqërore, duke përfaqësuar Islamin me urtësi dhe profesionalizëm.

Detajet e punësimit

- Lloji i pozitës: Me orar të plotë
- Vendndodhja: Melbourne, Australi
- Raporton tek: Këshilli Drejtues i AAIS
- Përfitime: Banesë dhe automjet i siguar
- Kërkesat e punës: Përfshin xhumatë, Ramazan, Bajrame dhe aktivitete të tjera komunitare
- Data e fillimit: Për t'u konfirmuar
- Kohëzgjatja e kontratës: Minimumi 2 vite

Përgjegjësitë kryesore

Udhëheqja fetare

- Udhëheqja e faljeve ditore dhe hutbeve të xhumasë
- Mbajtja e ligjëratave dhe këshillave fetare
- Udhëheqja e programeve të Ramazanit dhe Bajrameve
- Përgatitja dhe falja e xhenazeve dhe ceremonive të tjera fetare

Kujdesi pastoral

- Ofrimi i këshillave fetare dhe mbështetjes për individë dhe familje
- Këshillim me konfidencialitet dhe profesionalizëm
- Vizita sipas nevojës

Edukimi

- Organizimi i mësimave për të rinj dhe të rritur
- Përgatitja e materialeve të thjeshta edukative
- Mbështetja e zhvillimit fetar të të rinjve

Angazhimi komunitar

- Ndërtimi i marrëdhënieve me komunitetin shqiptar dhe më gjerë
- Përfaqësimi AAIS në aktivitete shoqërore dhe ndërfetare
- Promovimi i unitetit dhe respektit në komunitet

Administrimi dhe raportimi

- Raporte mujore pranë Këshillit
- Mbajtja e evidencave bazë për çdo aktivitet dhe shërbim.
- Pjesëmarrja në takime dhe komunikim i rregullt me udhëheqësinë.

Pritshmëritë kryesore

- Të përfaqësojë vlerat islame me sinqeritet, integritet dhe qëndrueshmëri.
- Të jetë person i afërt i ekuilibruar në mendime dhe i përqendruar në nevojat e komunitetit
- Të dëshmojë iniciativë duke bashkëpunuar ngushtë me udhëheqësinë.
- Ta ushtrojë detyrën me profesionalizëm, përgjegjësi dhe përkushtim.